



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DURRËS

NJOFTIM PËR VEND TË LIRË PUNE

Ne zbatim të ligjit nr. 8224 datë 15.05.1997 ndryshuar me ligjin 8335 datë 23.04.1998 “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë së Bashkise dhe të Komunes”, VKM nr.313 datë 01.07.2002 “Për caktimin e strukturës së numrit të punonjësve dhe shpenzimeve buxhetore të Policisë së Bashkise dhe Komunes”, ne ligjin nr.139 /2015”Për veteqeverisjen vendore”, VKB nr.488 datë 23.04.2018, Bashkia Durrës shpall konkurimin për vende të lira pune në pozicionin :

1.Polic pranë Policisë Bashkiake

Kërkesa të vecanta për kandidatet :

- Te kete arsim të mesem ose të lartë
- Te jete në moshën 19 – 27 vjeç
- Te kete të paktën 3 vjet eksperience pune
- Te kete aftësi të punës në grup, aftësi gjyqësore dhe të kontrollojë situata të krijuara të paparashikuara.
- Te kete aftësi të mira fizike dhe gjatësi trupore 1.75 cm
- Te kete njohuri mbi programet baze të kompjuterit.

Pershkrimi specifik i punës për pozicionin Polic pranë Sektorit të Policisë Bashkiake : Te zbatojë Urdherat e nxjerra nga Kryetari i Bashkise dhe Keshilli Bashkiak, të kontrollojë në zona të caktuara nga Bashkia dhe të bëjë konstatimin e parandalimit dhe shkeljeve administrative duke vepruar konform ligjit, të marrë masa për ruajtjen e pasurisë së Bashkise si dhe atyre që administrohen prej saj, të marrë masa për ruajtjen e rendit kur ka grumbullime njëzesh, të inspektojë tregjet, të kontrollojë zënien e vendeve për tregti ambulante.

Literatura : Testimi do të bazohet në ligjin 8224 datë 15.05.1997 ndryshuar me ligjin 8335 datë 23.04.1998 “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë së Bashkise dhe të Komunes”, ligjin nr.8553 datë 25.12.1999 “Për Policinë e Shtetit”, ligjin nr.8291 datë 25.02.1998 “Kodi i etikës së Policisë”, rregulloren “Tip” të Policisë së Bashkise dhe komunes, ligjin nr.139 datë 17.12.2015 “Për veteqeverisjen vendore”

Kandidati duhet të paraqesë brenda datës 23.05.2018 në Drejtorinë e Burimeve

Njerezore këto dokumenta :

1. Kërkesën për aplikim
2. Curriculum Vitae
3. Fotokopje të Deftesës të noterizuar ose e diplomes
4. Fotokopje të librezës punës
5. Dëshmi kualifikimi për kompjuterin
6. Vlerësim pune nga punëdhënësi i mëparshëm
7. Fotokopje e kartës së identitetit.
8. Dëshmi e gjendjes gjyqësore.

Pas verifikimit paraprak me datë 25.05.2018 në Bashki do të shpallet lista e aplikanteve që plotësojnë kushtet për testim dhe me datë 30.05.2018 do të zhvillohet testimi me shkrim dhe me gojë në këtë pozicion.